



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 34, datë 1.04.2020


**“PËR
PËRJASHTIMIN E PAGESËS SË QIRASË PËR PERIUdhËN MARS-PRILL 2020 TË TË
GJITHA FAMILJEVE QË JETOJNË PRANË BANESAVE SOCIALE NË ZONËN E
SHKOZËS, ISH-FONDERIA MEKANIKE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar, Ligjit nr.22/2018, “Për strehimin Social”, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Urdhrit nr.132, datë 08.03.2019 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19” të ndryshuar, Vendimit nr.243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni Covid -19, përjashtimin nga pagesa e qirave, si detyrime kontraktore që rrjedhin nga kontratat e qirave, të lidhura midis Bashkisë Tiranë dhe përfituesve të programit të banesave sociale me qira, në zonën e Shkozës, ish-Fonderia Mekanike, për periudhën Mars - Prill 2020.
2. Bashkia Tiranë të ndër marrë nismën për t’iu ardhur në ndihmë familjeve të strehuara pranë banesave sociale me qëllim që asnjë familje të mos humbasë banesën ku ato jetojnë për shkak pamundësisë financiare për të paguar qiranë për periudhën kohore të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Për familjet që kanë paguar qiranë e muajve Mars – Prill 2020, t’iu njihet si shlyerje pagese qiraje për muajin pasardhës.
4. Sipas parashikimeve të këtij vendimi, Bashkia Tiranë, ju bën thirrje të gjithë qiradhënësve privat që të shikojnë mundësinë për përjashtimin apo reduktimin e pagesës së qirasë për të gjithë ato qiramarrës që gjenden në vështirësi apo pamundësi financiare për shkak të gjendjes së krijuar nga infeksioni Covid-19.
5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.



...TIRANË...
...SHKURTIM...
...TIRANË...

...vendim...
...fuqi...
...ligj...
...vetëqeverisjen...
...ndryshuar...

VENDOSI:

1. Për të gjithë të cilët...
2. Për të gjithë të cilët...
3. Për të gjithë të cilët...
4. Për të gjithë të cilët...
5. Për të gjithë të cilët...